

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ABG Tech"

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, me date 26.02.2024, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "ABG Tech"

(2) Themeluesi i shoqërisë është ortaku i vetëm:

Z. AHMET BURAK GOKTEPE, shtetas Shqiptar, lindur ne Turqi, me 05.10.1970, mbajtes i ID me nr.033255663 dhe numer personal H01015143E, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Neni 2:
Objekti


2.1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Aktivitetet të inxhinierise energjetike, si shërbime për efijcencën e energjisë, projekte të planit të rinovueshëm të energjisë dhe projekte të menaxhimit të energjisë së rinovueshme, të inxhinierise se ndertimit si, konsulencë ekonomike dhe teknike, projektim teknik, shërbime modelimi matematikor, shërbime të modelimit numerik, shërbime të analizës gjeoteknike, shërbime të analizës strukturore, inxhinieri tunelesh, si dhe ato të inxhinierise mekanike. Shërbime të organizimit dhe planifikimit.

2.2 Shoqëria do të kryejë çdo lloje veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivave të saj, pjesëmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera.

Neni 3:
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë **pa afat**.



Neni 4:
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Tirane, Njesia Administrative nr. 7,
Rruga "Kavajës", Blloku "100 VITRINAT" Kulla C, kati I, apartamenti 6.

Shoqëria mund te krijoje gendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci
ne adresa te tjera ne territorin e Republikës se Shqipërisë se jashtë vendi.

Kreu II
Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 000 Lekë (njëqind mijë).

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është:

1. Ortaku themelues, **AHMET BURAK GOKTEPE**, shtetas Shqiptar, lindur ne
Turqi, me 05.10.1970, mbajtes i ID me nr:033255663 dhe numer personal
H01015143E: **Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 Lekë
(njëqind mijë), që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.**

Neni 6:

Znadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te znadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve
të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributive në
natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te
autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit behet nga ortaku i vetem, i cili merr vendim në të njëjtat
kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që
rrihedhin prej tyre mund të ftohohen apo kaloheh nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitjeje;
- c) trashëgimisë;
- d) dhuimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek ortake te tjere,
për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë
trashëgimie.



KREU III
ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

Ortaku i vetem eshte autoriteti i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i vetem eshte autoriteti i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Ortaku i vetem eshte autoriteti i vetem pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per qeshitet e meposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "ç" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dhi) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - e) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku i vetem mund të përfaqësohet, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë.

Neni 9
Administrimi

(1) Ortaku i vetem emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administrator/ret i shoqërie tregtare mënjë, sipas përcaktimit të neni 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administratorë i shoqërisë:



Te dhënat e identifikimit:

- **AHMET BURAK GOKTEPE**, shtetas Shqiptar, lindur ne Turqi, me 05.10.1970, mbajes i ID me nr.033255663 dhe numer personal H01015143E, madhor dhe aftësi te plota juridike per te vepruar.
- Speciment i nënshkrimit:

Neni 10

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
 - c) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e curisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrehanat, që kërkohenë mbartëvijën e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - e) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligji dhe në statut.
- Administratori eshte i detyruar te informoje ortakun, ne rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - shoqëria, brenda 2 vjeteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Ortaku i shoqërisë mund të shkaktojë administratorin në qdo kohë. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënive kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi

Neni 11

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamtatuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesim më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi qëshijet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezenti apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) i kthen ortakut të vetëm kontributet;
- b) i paguan ortakut të shoqërisë interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohet që shoqëria nuk do të kishite aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku i vetëm, ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse

është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblestë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertel

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfshihet viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Ekspertel

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit ekspert kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollin periodik të ushtruar, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimnore që ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 14

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Ortakut të vetëm;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - d) me vendim të gjykatës;
- Ne kete rast Ortaku merr vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerrte prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e sipër ”.

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku.

Nëse Ortaku nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 15 **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Ortakut, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 16

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.

O R T A K U I V E T E M

I SHOQËRISË ME PËRÇJEGJËSI TË KUFIZUAR **"ABC Tech"**

Ahmet Rind Gëllgeç

